

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6935  
E martë, 4 korrik 2023  
Çmimi 0.40 €

## Zhvillimet në veri dhe politikat e Kurtit, Abdixhiku nis takimet për daljen nga kriza

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# E NDËSHKUAR NGA BE-ja, ÇKA E PRET KOSOVËN?

FAQE 5



Pavarësisht prej thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar që Kosova t'i tërheqë kryetarët shqiptarë dhe të organizojë zgjedhje të reja në veri, hapa në këtë drejtim

nuk ka ende. Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane thotë se masat e BE-së mund të përshkallëzohen gradualisht nëse Qeveria e Kosovës

nuk ndryshon qëndrim. Ai ka theksuar se çdo masë represive e BE-së ndaj Kosovës, e dëmton kredibilitetin ndërkombëtar të vendit

## KLINTONI ZBRITI NË TIRANË, RAMA: ERDHI MIKU I PËRJETSHËM I KOMBIT SHQIPTAR

FAQE 3



## 66.04 PËR QIND KALUESHMËRIA E PROVIMIT TË MATURËS NË AFATIN E PARË

FAQE 3



## AKTUALE



### NË HAGË HAPET ZYRA NDËRKOMBËTARE PËR HETIMIN E LUFTËS NË UKRAINË

F. 2

### OSMANI DEKOROI ME MEDALJEN PRESIDENCIALE USHTARAKE UDHËHEQËSIT USHTARAKË AMERIKANË NË KFOR

F. 7

### AGK-JA ANGAZHON KONSULENT JURIDIK

F. 7

## EKONOMI



### FILLUAN PUNIMET NË RRUGËN NACIOALE PRISHTINË - PODUJEVË

F. 8

### KOSOVA DHE SHQIPËRIA DISKUTOJNË PËR SEKTORIN E ENERGJISË DHE AGJENDËN KLIMATIKE

F. 8

## SPORT



### LLAPI GODET ME DY TRANSFERIME, MALISHEVA ME NJË

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Në Hagë hapet zyra ndërkombëtare për hetimin e luftës në Ukrainë

**HAGË, 3 KORRIK** - Një zyrë ndërkombëtare që do të hetojë Rusinë për pushtimin e saj të Ukrainës është hapur më 3 korrik në Hagë. Ky është hapi i parë drejt një tribunali të mundshëm kundër udhëheqjes në Moskë. Qendra Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimin të Agresionit (ICPA) ka prokurorë nga Kievi, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC). Kjo zyrë do të hetojë dhe do të mbledhë dëshmi, në një lëvizje që po shihet si hap i përkohshëm para krijimit të një tribunali special, që mund të sjellë para drejtësisë zyrtarët e Kremlinit për nisjen e luftës në Ukrainë. Disa zyrtarët të lartë të ICPA-së do të mbajnë një konferencë për medie më vonë gjatë ditës. Në këtë konferencë pritet të flasin prokurori i përgjithshëm ukrainas, Andriy Kostin, prokurori i ICC-së, Karim Khan, ndihmësprokurori i përgjithshëm amerikan,

Kenneth Polite, dhe komisionari i BE-së për Drejtësi, Didier Reynders. Thirrjet për krijimin e një tribunali special për Ukrainën janë shtuar sepse ICC-ja, gjykata për krime të luftës që, po ashtu, ka selinë në Hagë, nuk ka mandat për ta hetuar krimin e gjerë të agresionit. ICC-ja po heton krime më specifike të luftës dhe krime kundër njerëzimit në Ukrainë dhe në mars lëshoi një urdhërarrestim për presidentin rus Vladimir Putin lidhur me supozimet për dëbimin e fëmijëve. Kievi po kërkon krijimin e një tribunali special që kur zbuloi qindra trupa pasi trupat ruse u tërhoqën nga qyteti Buça, afër kryeqytetit ukrainas, në prill të vitit 2022. Mbështetja ndërkombëtare për këtë ide është rritur dhe Komisioni Evropian në shkurt ka njoftuar për krijimin e ICPA-së. Brukseli ka thënë se kjo qendër ka "synimin kryesor t'i



ndjekë penalisht përgjegjësit e pushtimit" të Ukrainës. Përfshirja e ShBA-së u ka

dhënë më shumë fuqi përpjekjeve për krijimin e një tribunali special pavarësisht

prej faktit që Uashingtoni ende refuzon të bëhet pjesë e ICC-s.

## Qetësohet situata në Francë

**Paris, 3 korrik** - Trazirat në mbarë Francën, që u nxitën pas vrasjes së një 17-vjeçari, janë qetësuar në natën e gjashtë. Por, ndërtesat publike, makinat dhe koshat e plehrave, kanë qenë cak i zjarrvënies dhe vandalizmit gjatë natës. Ministria e Brendshme franceze tha se gjatë natës janë arrestuar 157 persona. Që nga 27 qershori, kur nisën trazirat, në Francë janë arrestuar 3 354 persona, teksa janë sulmuar edhe dy stacione policore. Afër 45 000 oficerë u dislokuan në mbarë vendin ku janë mbajtur protesta kundër diskriminimit ndaj personave që kanë prejardhje nga ish-kolonitë franceze dhe që jetojnë në lagjet me të ardhura të ulëta. Nahel, adoleshenti që u vra



të martën e kaluar, ishte me prejardhje algjeriane. Ai u vra nga një polic në Nanterre,

në periferi të Parisit.

Në mbarë Francën 297 makina janë djegur gjatë natës, ndërkaq

zjarrvëniet ka pasur edhe në 34 ndërtesa.

Një zjarrfikës 24 vjeç vdiq pas një

sulmi në zemër teksa po punonte në shuarjen e zjarrit në një garazh nëntokësor, tha policia në Paris. Shkaku i zjarrit në këtë ndërtesë banimi po hetohet, thanë autoritetet. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka fajësuar rjetet sociale për përhapjen e trazirave dhe u ka bërë thirrje prindërve të jenë përgjegjës për fëmijët e tyre adoleshentë. Ministri i Drejtësisë, Eric Dupond-Moretti, tha për një radio franceze se prindërit që heqin dorë nga kjo përgjegjësi "ose për shkak të mosinteresimit ose qëllimisht" do të ndiqen penalisht. Nahel, 17 vjeç, u vra gjatë një kontrolli në trafik. Familjarët e tij kanë bërë thirrje që të ndalen trazirat.

## Wagneri pezullon rekrutimin e mercenarëve

**MOSKË, 3 KORRIK** - Grupi famëkeq rus i mercenarëve Wagner, që kreu rebelimin më 23-24 qershor, ka ndaluar të gjithë procesin e rekrutimit. Ky grup njoftoi përmes kanalit në Telegram se "përkohësisht nuk po marrim pjesë në operacionin e posaçëm ushtarak dhe po zhvendosemi në Bjellorusi". Wagneri përdori shprehjen që Rusia përdor për t'iu referuar pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. Grupi Wagner kreu një rebelim të

shkurtër dhe mercenarët u nisën drejt Moskës. Por, më pas, lideri autoritar bjellorus, Alyaksandr Lukashenka, ndërmytesoi një marrëveshje dhe rebelimi u ndërpre. Sipas kësaj marrëveshjeje, shefi i Wagnerit, Yevgeny Prigozhin, u lejua të shkonte në Bjellorusi. Luftëtarëve të Wagnerit u është dhënë mundësia të zgjedhin nëse duan ta ndjekin Prigozhinin apo të integrohen në ushtrinë e regullt ruse. Prigozhini nuk është parë në publik që nga përfundimi i rebelimit.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

# Zhvillimet në veri dhe politikat e Kurtit, Abdixhiku nis takimet për daljen nga kriza

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se ditën e mërkurë do t'i nisë takimet me opinionistë dhe gazetarë, organizata të shoqërisë civile dhe të tjerë, ku do të diskutohet për politikat e qeverisë Kurti me aleatët historikë të saj. "Nga e mërkura do t'i organizojmë katër takime të para, me opinionistë dhe gazetarë, organizata të shoqërisë civile, profesorë universitarë, ish-diplomatë dhe biznese nga sektori privat në vend", ka thënë ai.

Ai ka theksuar se në të katër takimet e para do të diskutojnë jo vetëm për nevojën e ndërtimit të një mendimi dhe rrugëtimi të përbashkët euroatlantik, por dhe për propozimet e LDK-së për dalje nga kriza e tanishme izoluese e tensionuese. "Këto propozime do të përmbajtësohen nga vetë pjesëmarrësit, e rruga e re e Republikës do të lindë natyrshëm nga angazhimi gjithëshoqëror.

Kosova mundet më mirë. Kosova meriton më shumë", është shprehur Abdixhiku.

Ai ka bërë me dije se javën e shkuar ka shpallur idenë e nisjes së artikulumit të një mendimi të përbashkët shoqëror, si rrugë e re e Republikës së Kosovës, përballë politikave përplasëse të Qeverisë së Kosovës me aleatët historikë të saj dhe, së këndejmi, rrezikimit të shtyllave qenësore të sovranitetit dhe shtetësisë sonë. "Kam ftuar për angazhim të përbashkët të shoqërisë sonë, ata që besojnë në Republikën e Kosovës dhe rrugëtimin e saj euroatlantik, në artikulumin e qartë të kësaj rruge. Kam ftuar në angazhim mbipartiak e përtejpartiak si thirrje e fundit ndaj zhvillimeve të kohës. Jam i lumtur me reagimin e parë publik ndaj vetë iniciativës. Jam i lumtur me mbështetjen e gjerë të dhënë nga vetë akterët për këtë qëllim. Jam i bindur se shoqëria kosovare ka masën kritike të domosdoshme brenda saj, për të bërë gjënë e duhur në momentin e duhur. Dhe ky është momenti i duhur", ka thënë Abdixhiku.



## Fluturime me helikopterë dhe lëvizje të automjeteve ushtarake, KFOR-i do të kryejë stërvitje në disa komuna



PRISHTINË, 3 KORRIK - Trupat e KFOR-it të komandës rajonale Perëndimi (RC-W) do të zhvillojnë një stërvitje ushtarake në pjesën perëndimore të Kosovës nga data 4 deri më 6 korrik.

Sipas njoftimit për medie, thuhet se aktiviteti stërvitor do të kryhet nga kontingjenti shumëkombësh RC-W dhe do ta përmirësojë gatishmërinë dhe përgatitjen e njësisë. "Ushtarët dhe automjetet e KFOR-it do të vendosen në komunën e Istogut, Shtërpcës, Mamushës, Deçanit, Gjakovës, Dragashit, Hanit të Elezit dhe Kaçanikut. Aktivitetet stërvitore do të përfshijnë lëvizje tokësore ditën dhe natën, si dhe fluturime me helikopterë mbi komunën e Gjakovës, Shtërpcës dhe

Mamushës", thuhet në njoftimin e KFOR-it.

Karvanët e mjeteve të rënda do të kalojnë tranzit përgjatë rrugëve kryesore dhe dytësore brenda rajonit. "KFOR-i kryen ushtrime të tilla rutinë për qëllime provash dhe trajnimi për të ofruar një përgjigje në kohë dhe të sigurt. KFOR-i kërkon të sigurojë ndikim minimal në popullatën civile dhe të kufizojë çdo ndërprerje të aktiviteteve komerciale. KFOR-i është i përqendruar çdo ditë në zbatimin e mandatit të tij - bazuar në Rezolutën 1244 të OKB-së të vitit 1999 - për të siguruar një mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes, në të mirë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë", thuhet në njoftim.

## 66.04 për qind kalueshmëria e provimit të maturës në afatin e parë

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka publikuar rezultatet e Provimit Shtetëror të Maturës, të cilit i janë nënshtruar mbi 20 mijë nxënës të klasave të dymbëdhjeta në gjithë vendin. Këtë vit rezultati i përgjithshëm i kalueshmërisë është 66.04 për qind.

Rezultatet e Provimit Shtetëror të Maturës tashmë janë shpërndarë në shkolla. Provimi i mbajtur më 24 qershor është

organizuar në tri gjuhë: shqipe, boshnjake dhe turke dhe është mbajtur në 177 qendra të testimit.

Në këtë proces kanë qenë të angazhuar rreth 1 600 administrues të cilët kanë qenë të vendosur në çdo sallë të testimit dhe, po ashtu, edhe mbikëqyrës nga Universiteti i Prishtinës.

Gjatë procesit të administrimit ka pasur tentime për kopjim nga disa nxënës dhe si pasojë e posedimit dhe përdorimit të

telefonit janë përjashtuar 33 nxënës.

Këshilli Shtetëror i Maturës (KShM) ka konstatuar se procesi i testimit ka shkuar në rregull dhe se vendosja në një sallë e nxënësve nga klasa të ndryshme ka pasur ndikim pozitiv në administrimin e testit.

MASHTI i falënderon të gjithë të përfshirët në procesin e mbajtjes së Provimit Shtetëror të Maturës për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre.





# Masat e BE-së ndaj Kosovës, dështon mbledhja e Kryesisë së Kuvendit

Ka dështuar të mbahet mbledhja e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, e paraparë për të hënën e 3 korrikut. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për shkak të situatës së krijuar lidhur me sanksionet e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se partia e tij është e shqetësuar që qeveria e vendit ka mbajtur të fshehtë masat që janë marrë nga BE-ja

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, ka bërë me dije se kjo parti nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit e paralajmëruar për të hënën, për shkak, siç ka thënë ai, të masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. Ai ka thënë se LDK-ja nuk do të marrë pjesë as në të ardhmen në këtë mbledhje. "Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë për shkak të situatës së krijuar lidhur me sanksionet tashmë të konfirmuara nga zëdhënësi i Bashkimit Evropian dhe nga kryeministri i Kosovës. Ne si grup parlamentar vlerësojmë se është e dëmshme për Kosovën dhe është e pamundur të sillemi në mënyrë normale sikur nuk ka ndodhur asgjë. Prandaj, nuk do

të marrim pjesë në mbledhjen e Kryesisë as në të ardhmen dhe për masat dhe veprimet e mëtutjeshme do të merren vendimet në kryesinë e partisë shumë shpejt", u shpreh Gashi. Shefja e grupit parlamentar e LV-së Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se mbledhja e Kryesisë së Kuvendit ka dështuar për shkak të mungesës së nënkryetarit të LDK-së në këtë takim. "Sot siç mund ta shini nuk është mbajtur mbledhja e Kryesisë së Kuvendit. Mungoj nënkryetari i LDK-së, Kujtim Shala. Nuk kishim një paralajmërim nga ta", ka thënë Kusari-Lila. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se partia e tij është e shqetësuar që qeveria e vendit i ka mbajtur të fshehta masat që janë marrë nga BE-ja. Madje ai tha se masat e tilla e dëmtojnë raportin me vendet mike dhe se gjendja është e mjerueshme. "Shpreh shqetësimin e thellë që qeveria

tentoi t'i mbajë të fshehura masat e BE-së që kanë hyrë në fuqi. Qeveria Kurti nuk flitet për progres, por kemi hyrë në një fazë të zhvillimeve shqetësues. Masat e tilla e dëmtojnë raportin tonë me secilin vend veç e veç në BE. Gjithçka ka stagnuar dhe mendoj se jemi në një gjendje të mjerueshme nga kjo qeverisje. Sot nuk u arrit që të caktohet seanca, sepse kjo mazhorancë ka telashe edhe të brendshme", ka thënë Tahiri.

Ai ka thënë se zgjidhja për këtë qeveri është rrëzimi i saj por, sipas tij, për të pasur sukses, për këtë duhet të diskutohet, pasi si opozitë nuk i kanë numrat për mocion të mosbesimit.

## Lajçaku këtë javë në Kosovë dhe Serbi

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, gjatë kësaj

jave, me gjasë nga dita e martë, do të vizitojë Kosovën dhe Serbinë, në përpjekje për ta shtensionuar situatën në veri të Kosovës dhe për t'i bindur palët që të kthehen në dialog. Kështu mëson REL nga disa burime diplomatike, ndonëse në BE ende nuk e kanë konfirmuar zyrtarisht këtë vizitë.

Në Prishtinë Lajçaku pritet të takohet me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, e në Beograd me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq.

BE-ja vazhdon t'i përsërisë thirrjet për të dyja palët që të bëjnë hapa të menjëhershëm për shtensionimin e situatës dhe të kthehen në dialogun për normalizimin e raporteve që e ndërmjetëson Brukseli. Këto thirrje u bënë edhe gjatë samitit të fundit të liderëve të BE-së që u mbajt javën e kaluar në Bruksel. BE-ja po kërkon tërheqjen e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës nga afërsia e ndërtesave komunale në veri, paralelisht me tërheqjen e protestuesve serbë. Po ashtu, blloku evropian po kërkon tërheqjen e kryetarëve të rinj nga ndërtesat komunale, shpalljen e zgjedhjeve në veri dhe zotimin publik të serbëve se do të marrin pjesë në votime. Për shkak të mospërbushjes

së këtyre kërkesave, BE-ja ka nisur së zbatuari disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Por, në BE kanë thënë se "mbetemi të gatshëm të ndërmarrim masa edhe ndaj Serbisë nëse vlerësojmë se nuk po vepron sipas pritjeve".

Zyrtarët në BE kanë thënë se masat ndëshkuese ia kanë komunikuar Kosovës më 28 qershor.

Ato përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Masat e tjera përfshijnë edhe ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit). Propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor, po ashtu, nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29 dhe 30 qershor. Që kur janë rritur tensionet në veri në fund të majit, nuk ka pasur takime në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

## E ndëshkuar nga BE-ja, çka e pret Kosovën?

Pavarësisht prej thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar që Kosova t'i tërheqë kryetarët shqiptarë dhe të organizojë zgjedhje të reja në veri, hapa në këtë drejtim nuk ka ende. Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane thotë se masat e BE-së mund të përshkallëzohen gradualisht nëse Qeveria e Kosovës nuk ndryshon qëndrim. Ai ka theksuar se çdo masë represive e BE-së ndaj Kosovës, e dëmton kredibilitetin ndërkombëtar të vendit

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Të padrejta sipas institucioneve të Kosovës, të dëmshme sipas ekspertëve, komentohen masat ndëshkuese që Bashkimi Evropian ia shqiptoi Kosovës, për shkak të, siç u tha, mospërfilljes së kërkesave për shtensionimin e situatës në veri të vendit.

Në këtë zonë të banuar me shumicë serbe, tensionet janë të larta qysh në fund të majit, kur kryetarët shqiptarë të komunave hynë në zyrat e tyre, me gjithë rezistencën e banorëve lokalë serbë.

Protestat e tyre u përshkallëzuan edhe në përlëshje të dhunshme, me dhjetëra të plagosur - në mesin e të cilëve edhe ushtarë të misionit të NATO-s, KFOR.

Me gjithë thirrjet e komunitetit ndërkombëtar që Kosova t'i tërheqë kryetarët shqiptarë dhe të organizojë zgjedhje të reja, hapa në këtë drejtim nuk ka ende.

Në përgjigje, BE-ja pezulloi përkohësisht punën e të gjitha grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) - që është hapi i parë drejt anëtarësimit në bllok - si dhe ftesat për pjesëmarrjen e Kosovës në takime të nivelit të lartë. BE-ja pezulloi, po ashtu, programimin e fondeve për Kosovën, përfshirë ato nga IPA (Instrumentet e Para-Anëtarësimit në BE) dhe nga

Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor.

### Rrezik nga përshkallëzimi i masave

Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane thotë për Radion Evropa e Lirë se masat e BE-së mund të përshkallëzohen gradualisht nëse Qeveria e Kosovës nuk ndryshon qëndrim. "Sot kemi masa që i pezullojnë fondet, nuk i anulojnë ato. Shkalla e ardhshme do të jetë anulimi i fondeve", thotë Shasha. "Duke qenë se jemi një ekonomi në zhvillim, një ekonomi ende fragile në shumë aspekte, unë gjykoj se ato [masat ndëshkuese] do ta dëmtojnë shumë Kosovën", thotë Emrush Ujkani, drejtor ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë në Kosovë, për Radion Evropa e Lirë.

Nga Fondet IPA - që kanë për qëllim t'i ndihmojnë vendet që janë në procesin e anëtarësimit në BE në zbatimin e reformave - Kosova ka filluar të përfitojë mjete nga viti 2007. Nga ajo kohë deri në vitin 2022 vendi ka fituar në total 1.21 miliard euro.

Kosova nga viti 2009 mbështetet edhe nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor, e cila është një iniciativë e përbashkët



e BE-së, institucioneve financiare dhe donatorëve, që synon zhvillimin socio-ekonomik dhe të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në një dokument të këtij mekanizimi thuhet se në Kosovë janë mbështetur 30 projekte në vlerë prej 1.8 miliard eurosh deri në shtator të vitit 2021.

Projektet përfshijnë ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin e hekurudhave, sistemet e ngrohjes qendrore dhe përmirësimin e sistemit të ujërave të zeza.

### Si i komentoj qeveria masat ndëshkuese?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili vazhdimisht insiston se "nuk mund të bëjë kompromise me kushtetutshmërinë e vendit", tha se masat ndëshkuese të BE-së janë "të padrejta". Ai shfaq shpresën se ato do të jenë afatshkurtra pasi, siç tha, "Kosova është një vend që ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e saj". "Është e vërtetë që janë masa të përkohshme, por të padrejta, për shkak se Kosova dhe qeveria e saj janë edhe shteti, edhe ekzekutivi më demokratik,

pro-evropian dhe progresist", tha Kurti në fundjavë.

### Çfarë në lidhje me procesin integruar?

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në fund të vitit 2022.

Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ajo është e fundit në rrugën drejt BE-së. Deri më tani ka të nënshkruar vetëm një marrëveshje kontraktuale me bllokun, përkatësisht Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Blerta Deliu, anëtare e Komisionit për Integritet Evropian në Kuvendin e Kosovës, konfirmon për Radion Evropa e Lirë se dy takime, të parapara të mbahen në kuadër të MSA-së në Bruksel, janë anuluar tashmë. Sipas saj, bëhet fjalë për takimin e Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri BE - Kosovë, si dhe të Nënkomitetit për Tregti, Industri, Dogana dhe Taksa.

"Mospjesëmarrja e Kosovës në forume të tilla nuk i kontribuon agjendës sonë të forcimit të mekanizmave që e përafrojnë Kosovën me Bashkimin Evropian. Përkundrazi, e minon Kosovën në fuqizim, në rrugën e

saj euroatlantike dhe perëndimore", thotë Deliu, e cila vjen nga radhët e opozitës.

Shasha thotë se do të anulohet edhe një takim politik, përkatësisht ai i Këshillit të MSA-së ku, sipas tij, marrin pjesë ministrja e Jashtme dhe kryeministri i Kosovës, ndërsa nga BE-ja merr pjesë përfaqësuesi i politikës së jashtme.

Nëse nuk gjendet gjuhë e përbashkët, thotë Shasha, BE-ja mund të marrë masa edhe më represive. "Çka mund të bëjë? Mund të bëjë pezullimin e pjesëve të caktuara të MSA-së. Psh. ta ndalojë hyrjen e produkteve të Kosovës që kanë të drejtë të hyjnë në BE pa asnjë tarifë, falë MSA-së... si produktet e drurit, metalit, tekstilit...", thotë Shasha.

Ai shton se çdo masë represive e BE-së ndaj Kosovës e dëmton kredibilitetin ndërkombëtar të vendit.

Plani i BE-së për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës përfshin: tërheqjen e njësisve speciale të Policisë së Kosovës nga ndërtesat komunale në veri, zhvendosjen e kryetarëve nga objektet komunale - që shfrytëzohen edhe nga strukturat paralele serbe - në ndërtesa alternative, shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në veri dhe fillimin e procedurave gjyqësore kundër demonstruesve që sulmuan trupat e KFOR-it.

Për mospërfilljen e kërkesave për uljen e tensioneve, ShBA-ja ka ndërmarrë, po ashtu, masa ndëshkuese kundër Kosovës, duke e përjashtuar atë nga një stërvitje e madhe ndërkombëtare, e njohur si "Defender Europe 2023".

Kurti përsëriti të hënën se masat ndëshkuese, "për bindjen time të fuqishme, janë të padrejta".

## Klintoni zbriti në Tiranë, Rama: Erdhi miku i përjetshëm i kombit shqiptar

**TIRANË, 3 KORRIK** - Ish-presidenti amerikan, Bill Klinton, ka mbërritur sot në aeroportin e Rinasit, më pas është nisur drejt Tiranës.

Presidenti i 42-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës viziton sot për herë të parë tokën shqiptare. Ai do të qëndrojë në Shqipëri deri më 4 korrik, ditë që përkon me pavarësinë e ShBA-së.

Klintoni është prituri nga kryeministri Edi Rama, i cili e ka quajtur mik të përjetshëm të kombit shqiptar. "Me presidentin Bill Clinton, mikun e përjetshëm të kombit shqiptar, i cili sapo shkeli për herë të parë në Shqipëri", ka shkruar Rama në "Facebook".

Klintoni dhe delegacioni që e shoqëron do të pritjet me një ceremoni të posaçme zyrtare në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" nga kryeministri Edi Rama.



Gjatë ceremonisë shtetërore, Klintoni do të dekorohet me dekoratën e lartë "Ylli i Mirënjohjes për Arritjet Publike". Vizita e papritur e Klintonit u paralajmërua nga kreu i qeverisë, Edi Rama, i cili me nota misterie tha se kishte një dhuratë të madhe me datë 4 korrik për shqiptarët.

Ish-presidenti amerikan njihet edhe si president nderi për shqiptarët për shkak të ndikimit pozitiv që ka pasur për Shqipërinë dhe Kosovën.

Presidenca e Klintonit ndikoi në miratimin dhe realizimin e vendimeve të OKB-së për ndërhyrjen e NATO-s në luftën e Kosovës në vitin 1999, çka e detyroi presidentin e atëhershëm të ish-Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, t'i pranonte kushtet e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund fushatës së tij ushtarake kundër UÇK-së.

Në kuadër të vizitës së presidentit të 42-të të ShBA-së, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka marrë një sërë masash për sigurinë e ish-përfaqësuesit të lartë të shtetit amerikan, duke filluar nga aeroporti i Rinasit, shoqërimi drejt Tiranës në vendet ku do të zhvillohen takimet, akomodimi dhe shoqërimi drejt Rinasit, në përfundim të vizitës.

Një nga masat e planit konsiston në sigurimin e rrugëkalimit të ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Klinton, i cili do të zhvillojë takime me 3 dhe 4 korrik 2023 në Tiranë.

Policia e shtetit njofton qytetarët se do të ketë bllokime të disa segmenteve rrugore si dhe bllokime të pjesshme të disa segmenteve të tjera në varësi të takimeve dhe aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë këtyre dy ditëve në Tiranë.

## Policia rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi shqiptoi 739 gjoba

FERIZAJ, 3 KORRIK - Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion, me qëllim parandalimin e aksidenteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve policia rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi,

nga data 26/06/-02/07/2023, ka shqiptuar 739 gjoba kundërvajtëse, ndërsa ka hequr edhe 11 patentëshoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion. Ndërsa janë raportuar 36 aksidente, prej tyre aksidente me lëndime 17, persona të lënduar 24

dhe aksidente me dëme materiale 19. “Policia Rajonale e Ferizajt do t'i vazhdojë aktivitetet e shtuara me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe apelon te shoferët që të bëjnë kujdes në komunikacionin rrugor”, ka njoftuar policia.



## Inaugurohet parku dhe këndi i lojërave në Davidoc të Shtimes

SHTIME, 2 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në inaugurimin e parkut dhe këndit të lojërave në fshatin Davidoc të komunës së Shtimes, i cili është bashkëfinancim i qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunës së Shtimes, në vlerë prej 144 mijë eurosh, me një sipërfaqe prej 1 hektari. Pasi shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen në këtë ngjarje, kryeministri Kurti tha se në fund të vitit të kaluar bashkë me kryetarin Aliu kanë inauguruar edhe parkun tjetër në fshatin Gjyrkoc, i cili tashmë është bërë pjesë e komunitetit të fshatit dhe pikëtakim për fëmijët. “Urojmë që edhe ky park të kthehet në një vend ku shumë fëmijë dhe grupmosha të ndryshme do ta

kalojnë kohën e lirë dhe do të përjetojnë momente së bashku. Është pikërisht ky roli i komunës dhe i shtetit, që të krijojnë hapësira publike për qytetarët e saj, sepse janë këto hapësira publike ato të cilat inkurajojnë të kemi një lidhje të fortë të individit me vendin e tij, por edhe me qytetarët e tjerë të cilët i ndajnë këto hapësira”, ka thënë Kurti. Me këtë rast, kryeministri tha se shumë shpejt do të kemi inaugurime të reja në këtë pjesë, sepse pritet të fillojnë dy projekte të rëndësishme: rehabilitimi i rrugës rajonale transiti me 1.7 milion, si dhe rehabilitimi i rrugës rajonale Shtime - Lipjan me vlerë 1.5 milion euro. Kjo, sipas Kurti, do ta sigurojë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave në këtë komunë.



## Rektori Bajraktari zgjedhet kryesues i Konferencës së Rektorëve të Universiteteve të Kosovës



FERIZAJ, 3 KORRIK - Rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), prof. dr. Agron Bajraktari, është zgjedhur kryesues i Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike të Kosovës. Konferenca e Rektorëve, në mbledhjen e mbajtur të hënën në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, ka zgjedhur kryesues rektorin Bajraktari me vota unanime, ndërsa zëvendëskryesues i kësaj konference është zgjedhur rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Qerim Qerimi.

Rektori Bajraktari falënderoi rektorët e universiteteve publike të Kosovës për besimin e dhënë për udhëheqjen e kësaj konference, si dhe u zotua se do ta kryejë këtë detyrë me përkushtim, ashtu sikur edhe kryesuesit e mëparshëm. Po ashtu, rektori Bajraktari ka theksuar se do të punojë maksimalisht për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe ngritjen e cilësisë në këtë nivel të arsimit.

## Përfundon shtrimi me kubëza të betonit në 37 akse rrugore në Prizren

PRIZREN, 3 KORRIK - Ka përfunduar shtrimi me kubëza të betonit në 37 akse rrugore në Prizren, në kuadër të projektit

“Ndërtimi i rrugëve lokale në Lubizhdë të Hasit” që, përveç estetikës në fshat, rregullimi i infrastrukturës ka lehtësuar qarkullimin e

automjeteve dhe të këmbësorëve. Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se në kuadër të këtyre punimeve

po instalohet dhe ndriçimi në disa pjesë të fshatit që do ta ngrehë nivelin e sigurisë për lëvizje gjatë natës.



## Shpërthim në Mitrovicë të Veriut

MITROVICË, 3 KORRIK - Policia e Kosovës ka njoftuar se në orët e para të 3 korrikut ka ndodhur një shpërthim në Mitrovicë të Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe. Sipas policisë, mjete që ka shpërthyer dyshohet të ketë qenë shok-bombë.

Ngjarja ka ndodhur në orën 00:52 në lagjen Tre rrokaqejt. Zyrtarët policorë, sipas njoftimit, "nuk kanë hasur në dëme anësore" nga ky shpërthim.

Lista Serbe ka dënuar shpërthimin në Mitrovicë të Veriut, duke thënë se përfaqësuesit e kësaj partie janë të bindur që kjo "është bërë qëllimisht për ta arsyetuar praninë e shtuar të njëjve speciale policore [të Kosovës]".

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka përsëritur kërkesën për misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe atë të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, që ta rritin praninë e tyre në veri, veçmas në Mitrovicë të Veriut.

Shok-bombat nuk konsiderohen mjete shkatërruese, megjithatë ato prodhojnë zhurmë të madhe që çorienton shqisat.

Së fundmi, në komunat në veri të Kosovës janë regjistruar disa sulme me shok-bomba dhe granata dore.

Sulmi i fundit me shok-bombë ndodhi në Zveçan më 18 qershor. Po ashtu, sulme me shok-bomba ka pasur edhe pranë stacioneve në Zveçan dhe



Mitrovicë të Veriut.

Më 26 qershor objekti komunal i Mitrovicës së Veriut u sulmua me granatë dore, duke shkaktuar dëme materiale.

Këto ngjarje vijnë në kohën kur

tensionet në veri të Kosovës janë rritur që nga 26 maji. Atë ditë kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri - të banuara me shumicë serbe - kanë hyrë në ndërtesat komunale të Zveçanit,

Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Popullata serbe, e cila i ka bojkotuar zgjedhjet e 23 prillit, e ka kundërshtuar veprimin e kryetarëve dhe ka mbajtur vazhdimisht protesta para

ndërtesave.

Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i ulin tensionet dhe të organizohen zgjedhje të reja në katër komunat në veri.

## Osmani dekoroi me Medaljen Presidenciale Ushtarake udhëheqësit ushtarakë amerikanë në KFOR

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Me rastin e përfundimit të mandatit të tyre, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Ushtarake kolonelin Chris M Mabis dhe nënkolonelin Jared B. Sheets, për udhëheqjen dhe përpjekjet e jashtëzakonshme për garantimin e sigurisë, paqes dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës gjatë shërbimit të tyre në kuadër të forcave paqeruajtëse të KFOR-it në Kosovë.

Ajo, gjithashtu, i ka dhënë Mirënjohje Presidenciale togere Ryann Laky nga Shtabi i Gardës Kombëtare të Indianës për kontributin në ndërlidhjen dhe bashkëpunimin me Policinë e Kosovës si dhe fuqizimin e grave



në sektorin e sigurisë.

Pasi që i ka falënderuar të tre ushtarakët amerikanë dhe të

gjithë ushtarë e KFOR-it për angazhimin e tyre për garantimin e sigurisë dhe lirisë së

lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke rrezikuar edhe jetën e tyre, presidentja Osmani theksoi

se lidhshipi i tyre ka luajtur rol thelbësor në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon në një kohë të ndjeshme. "Populli i Kosovës është përherë falënderues ndaj kontributit të pazëven-dësueshëm dhe të çmuar të Ushtrisë amerikane dhe ushtrive të tjera aleate për paqen dhe stabilitetin. Marrëdhëniet tona me ShBA-në janë ekzistenciale dhe nuk do të ndalemi në angazhimin për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve strategjike në mes të Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka theksuar presidentja Osmani në këtë ceremoni.

Ndërkaq ushtarakët amerikanë falënderuan presidenten Osmani për nderimin, duke shfaqur shpresën që paqja dhe stabiliteti të jenë afatgjatë në Kosovë, njësoj sikurse edhe raportet me ShBA-në.

## AGK-ja angazhon konsulent juridik

PRISHTINË, 3 KORRIK - Me mbështetjen e dhënë nga OSCE Mission in Kosovo, Yll Zekaj është angazhuar konsulent juridik për t'i

ofruar ndihmë juridike Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe anëtarëve të saj. "Mbrotjtja ligjore për komunitetin

është tejet e rëndësishme për Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, andaj i inkurajojmë të gjithë kolegët që t'i raportojnë

rastet kur pengohen gjatë kryerjes së detyrës, ose janë cak i sulmeve dhe kërcënimeve", ka njoftuar AGK-ja.



# Filluan punimet në rrugën nacionale Prishtinë - Podujevë

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PODUJEVË, 3 KORRIK** - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar punimet e zgjerimit të Rrugës Nacionale N25, Prishtinë - Podujevë. "Rruga Prishtinë - Podujevë është e vjetër gjysmë shekulli dhe ka qenë nevojë e kamotshme e trevës së Llapit që të lidhet me kryeqytetin në mënyrë efikase", ka thënë Kurti, duke shtuar se do të bëjmë çmos që kjo rrugë të përfundojë sa më parë.

Ai ka theksuar se "jemi në rrugë të mbarë për të përfunduar këtë zgjerim i cili është i rëndësishëm jo vetëm për shpejtësinë e lidhjes me kryeqytet, por edhe për sigurinë e të gjithë udhëtarëve pasi, siç veçoi ai, këto vitet e shkuara kemi pasur shumë

aksidente me fatalitet". Bashkë me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, zëvendësministrin e kësaj ministrie, Hysen Durmishin, si dhe me kryetarin e komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, kryeministri pa nga afër punimet e rrugës me gjatësi 15 kilometra, projekt në vlerë 35 milionë euro.

Kryeministri Kurti përgëzoi ministrin Aliu dhe zëvendësministrin Durmishi për angazhimin për përgatitjet dhe planifikimin, meqë ngecja e madhe ka ekzistuar pikërisht për shkak se kanë hyrë në ekzekutim pa planifikim e pa përgatitje. Ministri Liburn Aliu dha hollësi për këtë projekt, duke treguar se projekti i zgjerimit



të rrugës Prishtinë - Podujevë është projekt i cili i ka 5 lote, ku 4 lotet janë për zgjerim të rrugës ekzistuese, ndërsa loti i pestë është finalizim i tashmë lotit të mëhershëm që është nga Lluzhani deri në Podujevë. "Jemi të përkushtuar dhe të vendosur që kjo rrugë të kryhet në kohë, që të kemi cilësi të punimeve e paralelisht me këtë edhe për projekte të tjera, për ato të cilat kemi pasur ngecje të vazhdueshme nga e kaluara të cilat janë duke u zgjidhur një për një, po ashtu edhe për projektet e reja që presin të fillojnë dhe të na vijnë në muajt në vijim", u shpreh ai. Kurse zëvendësministri Durmishi shtoi se ky është projekti i parë që si ministri e

realizojnë me të gjitha fazat. "Prej fazës së projektimit e deri në ekzekutim të punimeve, i kemi marrë të gjitha masat që ky projekt të realizohet me dinamikë të shtuar brenda afateve që janë të përcaktuara në kontratë në mënyrë që të mos kemi zvarritje", ka thënë ai. Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, duke falënderuar Qeverinë e Kosovës për këtë mundësi të madhe për qytetarët, tha se ky është një projekt i shumëpritur, për arsye se kjo rrugë pati shkaktuar shumë vështirësi në qarkullim për shkak të numrit të madh të automjeteve dhe qytetarëve të cilët lëvizin në drejtim të Prishtinës.

## Kosova dhe Shqipëria diskutojnë për sektorin e energjisë dhe agjendën klimatike

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Ministri i Mjedisit, Liburn Aliu, së bashku me ministrin e Ekonomisë, Arta Rizvanolli, kanë marrë pjesë në takim informel të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, me nikoqire Republikën e Shqipërisë.

Në këtë takim ministri Aliu ka përshkruar qëndrimin dhe vizionin e Republikës së Kosovës në lidhje me sfidat aktuale të ndryshimeve klimatike dhe rrugën drejt implementimit të agjendës klimatike.

"Një temë kyçe e diskutimit ishte krijimi i Sistemit të Tregtisë së Emetimeve në kuadër të Komunitetit të Energjisë dhe Mekanizmit të Rregullimit të Karbonit në Kufi

(CBAM), mekanizmat që ndikojnë në sektorin e energjisë elektrike si dhe sektorët e tjerë që emetojnë gazra serë. Për këtë kemi shprehur shqetësimet tona pasi që për të ardhur në vendimmarrje të informuar, është e rëndësishme ta kryejmë analizën e ndikimit të CBAM në industri dhe sektorin e energjisë, duke përfshirë edhe mbështetjen që nevojiten për t'i adresuar sfidat që paraqet CBAM", ka thënë Aliu. Ai ka potencuar që Republika e Kosovës së shpejti do ta dorëzojë draftin fillestar të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP), të përgatitur me ndihmën e GIZ-it dhe German Economics Team.





# Colin Farrell: Teknologjia, që po na sjell varfërimin shpirtëror

Në moshën 46-vjeçare vazhdon të ketë ende qëllimin që për të është më i rëndësishëm: “Të shpreh nevojat e mia me ndershmëri dhe dashuri, në marrëdhënien sentimentale, me miqtë, me fëmijët e mi”. Për të praktikuar luanin rolin e një njeriu vetmitar, të cili i ka mbetur vetëm një gomar



Nga Cristiana ALLIEVI

Nga njëra anë, ai jep shumë pak intervista. E bën këtë për të mos rillexuar çdo herë një të kaluar, për të cilën ka punuar shumë për ta lënë pas. Por nga ana tjetër, njeriu që ka 20 vite që ka flirtuar me telashet (alkool dhe drogë, paparacë dhe video seksuale që përfunduan në rrjet) është si një përrua i vrullshëm kur flet.

Colin Farrell është një burrë plot jetë dhe gjëra të mira për të ndarë me të tjerët, dhe ditën e intervistës tonë ai është i veshur me ngjyra të çelura, i mban flokët shkurt dhe është në humor të mirë. Njeriu që është përndjekur kaq shumë nga fotografët sa që vendosi të vishte një bluzë ku shkruhej “Lëreni rehat Colin!”, një gjetje që pati aq shumë sukses sa që u shndërrua në një linjë veshjesh, ka arritur sot të zbulojë një të vërtetë të rëndësishme, e cila e ka bërë akoma më të pjekur: “Vetmia është gjithnjë e më thelbësore për mua, dhe këtë e zbulova falë pandemisë”.

Pikërisht në vetminë e ishullit Inishmore, ishullit më të madh në arkipelagun irlandez Aran, ai xhirooi filmin i cili tashmë i ka dhuruar Coppa Volpi në Venecia dhe një Golden Globe, dhe me

shumë gjasa këtë muaj do ta çojë në fitimin e Oscarit të tij të parë. Filmi “Shpirtrat e isuhllit” tregon jetën në një vend, ku përveç gjelbërimit të shumëpërhapur, nuk ka shumë gjëra që mund të bëhen. Aty ka vetëm një pijetore dhe një komuniteti banorësh shumë të mbyllur dhe fanatikë. Në këtë ambient, Padraic (Farrell) është një burrë që kujdeset për gomarin e tij prej vitesh, dhe Colm (Brendan Gleeson) është një mik i përrjetshëm që befas nuk dëshiron më ta shohë apo të flasë me të.

**“Nuk të dua më”, “Nuk jam më shoku yt” janë frazat që lëndojnë thellë. Çfarë mendoni për një komunikim kaq të drejtpërdrejtë?**

Unë mendoj se njerëzit përdorin një gjuhë “brutalisht të ndershme” për të justifikuar të qenit mizor dhe të poshtër. Nga ana tjetër, konstatoj se ka një poshtërsi edhe në komunikimin e së vërtetës së asaj që dëgjojmë.

**Në këtë rrugë drejt komunikimit të ndjenjave, ku jeni ju vetë?**

Edhe pse jam 46 vjeç, po mësoj ende si të shpreh mendimet dhe nevojat e mia, dhe kjo vlen për

miqësitë, marrëdhëniet romantike dhe marrëdhëniet me dy fëmijët e mi. Dua të jem i sinqertë dhe të shprehem me dashuri, por kjo nuk i lehtëson gjërat, përkundrazi.

**Cila është gjëja më e rëndësishme që keni kuptuar mbi marrëdhëniet njerëzore?**

Që shumë shpesh e harrojmë se përgjegjësia në një marrëdhënie bie 50 për qind mbi ne. Nëse e harrojmë këtë koncept ky është një problem serioz.

Ndërprerje e një marrëdhënieje apo përpjekje për ta ndryshuar atë nga brenda: cilën rrugë do të zgjidhni ju vetë?

Unë nuk jam një adhurues i madh i të kundërtave, të drejtës dhe të gabuarës. Të gjithë jemi dakord se nuk është e përshtatshme të lëndosh dikë me vetëdije dhe ta shijosh dhimbjen e shkaktuar. Por ndërkohë besoj se ndonjëherë, nëse bëj vërtet zgjedhjen më të mirë për vete, ajo nuk përputhet domosdoshmërisht me atë që do të donin njerëzit në jetën time.

**Një ekuilibër shumë delikat...**

Shumë i vështirë, sepse në thelb të gjithë ne mendojmë se

lumturia dhe gëzimi i të tjerëve varen nga ne. Në fakt duhet të dish të durosh trishtimin, të shkosh përtej kësaj skeme. Por unë mendoj se të rinjtë janë më të aftë t'i thonë disa gjëra njëri-tjetrit dhe të mbeten miq.

Për Padraic, gomari i tij është shumë i rëndësishëm. Keni edhe ju të njëjtën ndjenjë ndaj kafshëve?

Kafshët janë të sinqerta, nuk janë as konceptuale dhe as “me 2 standarte”. Ato janë thjesht të pranishme në jetën tënde, janë të natyrshme. Po ju tregoj një histori të pabesueshme. Burri i vëllait tim Eamon, Steve, kishte melanoma. Kur e mori vesh, kuptoi se qeni i tij kishte 1 vit e gjysmë që sillej gjithmonë rreth tij, duke e nuhatur pikërisht zonën e trupit ku e gjetën masën kanceroze: pra qeni e nuhati helmin e kancerit.

Gjashtë muaj pas diagnozës, qeni u sëmur me të njëjtën sëmundje si Steve, melanoma. Kjo tregon një ndjenjë të atillë ndjeshmërie që i nxit kafshët të reagojnë ndaj asaj që ndodh. Ato kanë një mënyrë shumë thellë për të jetuar të tashmen, të cilën ne njerëzit e shpërdorojmë duke e intelektualizuar jetën tonë, për shkak të egos, krenarisë dhe frikës.

A keni pasur ndonjëherë një përvojë të ngjashme me atë të Padraic, ku dikush shkëputet me ju në mënyrë të dhunshme?

Jo në atë mënyrë, që është e tmerrshme, dhe unë nuk e mendoj se i kam investuar ndonjëherë emocionet e mia në një drejtim të tillë. Megjithatë po përshkruajmë dhimbjen, dhimbjen nga izolimi, që shfaqet në forma të ndryshme. Mund ta krahasoja me vdekjen e gjyshërve të mi.


**Meqë po flasim për izolimin, a po na tjetërsojnë mediat sociale?**

Ato po na largojnë nga intimiteti dhe interesimi për të biseduar. Mua më pëlqejnë bisedat, edhe nëse ndonjëherë mendimet dhe ndjenjat na shtyjnë të gjykojmë shumë shpejt, shkëmbimi i ideve me dikë që është i gatshëm ta ndryshojë mendimin e tij është diçka e shkëlqyer.

Çfarë mendoni për zëvendësimin e bisedave me teknologjinë? Është një varfërim i madh. Edhe sepse nëse është e vërtetë që të gjithë jemi të prekur nga një lloj vuajtjeje, është gjithashtu e vërtetë që duke biseduar, ne kemi mundësinë të ndajmë gëzimin. Dhe ta bësh këtë gjë është shumë bukur. Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Ademi takohet me Berishën, bisedojnë për investimet në stadiumin ‘Ekrem Grajçevci’

PRISHTINË, 3 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në takim kryetarin e komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha dhe kryetarin e KF Fushë-Kosova, Bashkim

Ismajli. Fillimisht i pari i FFK-së e ka përgëzuar edhe njëherë KF Fushë-Kosova dhe qytetarët e kësaj komune për rikthimin në Superligë, duke shprehur bindjen për paraqitje sa më të mira. Gjatë takimit u diskutua

për organizimin e këtij klubi për Superligë dhe për kriteret që duhet të përmbushen veçmas në aspektin e infrastrukturës. Ademi dhe Berisha u pajtuan për të nënshkruar një Memorandum

Bashkëpunimi në mënyrë që të kryhen investimet e nevojshme në stadiumin “Ekrem Grajçevci”, që ai t’i plotësojë kushtet dhe kriteret për zhvillimin e ndeshjeve në Superligë.



## Llapi godet me dy transferime, Malisheva me një

Skuadra e Llapit ka transferuar Ergyn Ahmetin dhe Muhamet Hysenin. Skuadra e Tahir Batatinës pret që dy lojtarët e paraqitur të hënën të jenë të vlefshëm për skuadrën në sezonin e ri të futbollit. Ahmeti ka përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, ndërsa Hyseni ka shkëlqyer me skuadrën e Feronikelit 74'. Skuadra tjetër e elitës, Malisheva, e ka transferuar talentin Laurent Xhylani

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 KORRIK - Futbollisti i njohur dhe me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Ergyn Ahmeti, është transferimi më i ri i skuadrës së Llapit. Mesfushori ishte pjesë e Dukagjinit nga Klina, ndërsa më herët ka luajtur edhe për Prishtinën dhe Dritën. “Në praninë e drejtorit sportiv, Mentor Zhdrella, Ahmeti ka firmosur kontratën e vlefshme deri në vitin 2024. Ahmeti do jetë forcë shtesë për repartin e mesfushës dhe do të bashkohet me ekipin tonë në përgatitjet për edicionin e ri. Mirëpresim ardhjen e mesfushorit kreativ Ergyn Ahmeti në familjen tonë bardhekaltër, duke i dëshiruar suksese dhe paraqitje sa më

dinjitoze”, thuhet në njoftimin e Llapit.

27-vjeçari mitrovicas ka fituar dy herë Kupën e Kosovës me Prishtinën dhe është paraqitur në ndeshjet ndërkombëtare me klubin kryeqytetas dhe Dritën, ndërsa përvoja e tij do jetë ndihmesë e madhe për skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina për edicionin e ri.

Llapi brenda ditës e ka bërë edhe prezantimin e dytë. Ish-futbollisti i Feronikelit 74', Muhamet Hyseni, ka “aterruar” në stadiumin “Zahir Pajaziti” dhe në sezonin 2023/2024 do të jetë nën urdhrat e trajnerit Tahir Batatina. Sulmuesi 22 vjeç, Muhamet Hyseni, pas dy vitesh të kaluara te Malisheva e Feronikeli 74, rikthehet sërish në shtëpinë e tij. “Golashënuesi më i mirë i



Feronikeli 74 me 16 gola e 6 asistime, në prani të drejtorit sportiv, Mentor Zhdrella, ka firmosur kontratë trivjeçare. Hyseni është ndër futbollistët që ka kontribuar në fitimin e Kupës së parë, duke shënuar penalltinë vendimtare që ia solli klubit tonë trofeun e parë pas 89 vjetësh klub.

Duke parë kualitetet e tij dhe sezonin fantastik që ka kaluar me Feronikeli 74, ku me golat dhe asistimet e tij ishte ndër futbollistët më vendimtar, klubi ka qenë i bindur se rikthimi i tij do jetë më se i duhur për fazën ofensive. Sulmuesit Muhamet Hyseni i dëshirojmë

mirëseardhje sërish në mesin tonë dhe i dëshirojmë suksese dhe një sezon të mbarë.

Presim që këtë edicion dhe në edicionet e ardhshme ta kryejë punën e tij siç di më së miri, t’i tundë rrjetat kundërshtare me fanellën e klubit të tij të zemrës”, thuhet në njoftimin e skuadrës llapjane.

Të hënën aktive në tregun e transferimeve ishte edhe skuadra e Malishevës, e cila e ka transferuar talentin Laurent Xhylani, i cili në kampionatin e fundit ishte pjesë e skuadrës së Drenasit, derisa skuadra e re e shih si një futbollist me perspektivë të madhe për të ardhmen. “FC Malisheva konfirmon arritjen e manëveshjes për transferimin e top-talentit Laurent Xhylani nga KF Drenasi. Klubi njofton se ka nënshkruar kontratë afatgjatë me njërin nga talentet më premtues në futbollin kosovar. Laurenti edhe pse një talent i ri, është transferimi i së tashmes e, po ashtu, edhe i së ardhmes së klubit”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Malishevës, e cila deri tash ka bërë mjaft ndryshime si në radhët e futbollistëve, po ashtu edhe në shtabin teknik.

## Berisha nuk largohet nga Sigal Prishtina



PRISHTINË, 3 KORRIK - Basketbollisti Dardan Berisha do të jetë pjesë e Sigal Prishtinës edhe për sezonin e ardhshëm të Superligës së Kosovës në basketboll. Kjo është konfirmuar nga kryetari i Sigal Prishtinës, Blerand Stavileci, i cili e ka konsideruar reprezentuesin e Kosovës “të paprekshëm”. “E para, Dardani ka kontratë me Prishtinën, siç kanë edhe një pjesë e

konsiderueshme e lojtarëve vendorë që kanë qenë vitin e kaluar. Ne kemi dashur që njëherë t’i mbyllim këta lojtarë dhe pastaj të bisedojmë me secilin për të parë se cili është dhe cili mund të mos jetë në planet e trajnerit... Lojtarët mund të kontaktohen nga secili klub, nga agentët të ndryshëm, por Dardani ka kontratë për dy sezone me Prishtinën, është kontratë që

është nënshkruar vitin e kaluar. Pra Dardani është dhe do të jetë lojtar i Prishtinës. Gjithmonë në klube ka lojtarë që janë të paprekshëm dhe ka lojtarë me të cilët ndoshta mund të bisedohet”, ka thënë Stavileci për “KosovaPress”. Javët e fundit Berisha ishte lidhur me një lëvizje, përkatësisht rikthim te klubi i basketbollit Peja, por që kjo nuk do të ndodhë.

## Mbyllen Lojërat Evropiane Krakow dhe Malopolska 2023

PRISHTINË, 3 KORRIK - Me ceremoninë e organizuar në stadiumin e Krakowit, është mbyllur edhe zyrtarisht edicioni i tretë i Lojërave Evropiane i cili është mbajtur prej 22 qershorit deri më 1 korrik në rajonin e Krakows

dhe Malopolskasë së Polonisë. Lojërat të mbyllura i shpalli presidenti i EOC-ut, Spyros Capralos, i cili falënderoi Poloninë për organizimin e shkëlqyer. Për herë të parë ekipi i Kosovës mbylli Lojërat pa fituar

medalje, ndërsa arritja më e madhe ishte vendi i pestë me boksieren Donjeta Sadiku, si dhe hyrja në tetë më të mirët e tekbollistit Adrien Uka. Ekipi i Kosovës u përfaqësua me 38 sportistë të tetë sporteve të ndryshme.



## Newcastle zyrtarizon Tonalin

Newcastle upon Tyne, 3 korrik - Klubi i Premierë Ligës, Newcastle United, e ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit Sandro Tonalin. Reprerentuesi italian ka

nënshkruar kontratë me klubin anglez deri në vitin 2028. "Kemi kënaqësinë të njoftojmë për nënshkrimin e Sandro Tonalit nga AC Milan. 23-vjeçari ka rënë dakord për

një kontratë në 'St. James Park' fillimisht deri në vitin 2028", thuhet në njoftimin e Newcastle. Është raportuar se Newcastle ka paguar rreth 70 milionë euro për

transferimin e Tonalit, i cili ishte pjesë e Milanit nga viti 2020 kur u transferua nga Brescia. Ai te Milani është konsideruar si një nga futbollistët më të mirë.



## Mbahet kampi për gjyqtarët fillestarë të basketbollit



PRISHTINË, 3 KORRIK - Më 1 dhe 2 korrik në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë është mbajtur kampi përmblyës nga ana praktike për gjyqtarë fillestarë, të cilët, pas licencimit, para fillimit të edicionit 2023-2024, do të jenë pjesë e nominimit në ndeshjet e kategorive të reja. Kampi u organizua nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës. Pikat nga puna praktike janë demonstruar

nga FIBA Instruktorit Nacional, Faton Kurshumlija. Të gjithë gjyqtarët kanë qenë shumë aktivë gjatë punës, duke komunikuar në mënyrën më të mirë dhe duke parashtruar pyetje nga rregullat e basketbollit dhe mekanika 2 PO dhe e kanë quajtur mbajtjen e Kampit si shumë të suksesshëm. Pas përfundimit të punës praktike të gjithë gjyqtarët pjesëmarrës me sukses i janë nënshtruar testit teorik nga njohja dhe interpretimet e rregullave të

basketbollit. Kandidatët pjesëmarrës kanë treguar aftësi, talent dhe njohuri shumë të mirë nga loja e basketbollit dhe i kanë plotësuar kushtet për licencimin nga FBK-ja me titullin gjyqtar fillestar. Pjesëmarrës në punën praktike ishin 13 gjyqtarë, si dhe 7 gjyqtarë/e nga Shoqata e Gjyqtarëve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (ShGjFBK) kanë asistuar në punën e FIBA Instruktorit Nacional të Gjyqtarëve.

## Joshua më 12 gusht përballet me Whyten



LONDËR, 3 KORRIK - Boksieri britanik Anthony Joshua, ish-kampion bote në peshën e rëndë, do të ndeshet më 12 gusht ndaj patriotit të tij Dillian Whyte. Palët kanë firmosur kontratat dhe sfida do të zhvillohet në stadiumin "O2 Arena" të Londrës. Lajmin e konfirmoi të hënën Eddie Hearn, promotori i njohur i

boksit, njëkohësisht menaxheri i Joshuas. Kjo do të jetë sfida e dytë mes dy boksierëve, me Joshuan që ka fituar tetë vjet më parë me KO teknik duelin e parë mes tyre, zhvilluar po në këtë stadium. "Kontratat janë firmosur dhe tani do ta zyrtarizojmë duelin. Do të jetë një përballje e madhe dhe boksierët do të dhurojnë spektakël

në ring", ka thënë Eddie Hearn, që konfirmoi sfidën e madhe. Interesant fakti se të dy boksierët kanë duelin për herë të fundit ndaj të njëjtut rival: Jermaine Franklin. Joshua (25 fitore e 3 humbje) e mposhti më 1 prill të këtij viti, ndërsa Whyte (29 fitore e 3 humbje) e ka mundur në nëntor të vitit të kaluar.

### SHKURT

#### Augsburgu synon ta shesë Berishën pesë herë më shtrenjtë sesa që e bleu

Mërgim Berisha ka shkëlqyer me fanellën e Augsburgut në edicionin e kaluar duke regjistruar 23 ndeshje në Bundesliga, kurse realizoi nëntë gola dhe dhuroi katër asistime. Augsburgu e kishte në huazim nga Fenerbahçe lojtarin me prejardhje shqiptare dhe vendasi ta blejë kartonin e tij. Klubi gjerman e bleu për katër milionë euro kartonin e sulmuesit të Kombëtares së Gjermanisë, derisa tash po synon ta shesë për 20 milionë euro. Revista gjermane "Kicker" ka raportuar se për Berishën interesim ka treguar skuadra e Wolfsburgut.

#### Daku transferohet në Rusi

Sulmuesi Mirlind Daku është gati për një aventurë të re në Rusi te skuadra e Rubin Kazanit. Ai duket se i ka dhënë fund aventurës me Osijekun në Kroaci, me këtë të fundit që pritet të përfitojë nga ky operacion 1.2 milion euro. Daku ndodhet në Kazan për t'i kryer vizitat mjekësore dhe më pas për të firmosur një kontratë trevjeçare, nga e cila do të përfitojë një milion euro në sezon.

#### Laporta: Messi? Ai donte më pak presion

Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka analizuar situatën aktuale të Barcelonës në një intervistë të dhënë për "La Vanguardia". Ndër temat e trajtuar është edhe mosardhja e Leo Messit. "Ne kishim një marrëveshje me La Ligën, do t'i kushtonim një pjesë të burimeve që kemi për Messin. Ishte parashikuar në planin e fizibilitetit. Ne ia komunikua atë Jorge Messit. Ai na tha se Leo kishte kaluar një vit shumë të vështirë në Paris dhe se ai donte më pak presion. Ne do të bëjmë një event për 125-vjetorin e klubit dhe do të ishim të nderuar që Messi të ishte në 'Camp Nou' në këtë ditë për ta nderuar për atë që ka dhënë për këtë fanellë", është shprehur Laporta.

#### Vieira merr drejtimin e Strasbourgut

Legjenda e Arsenalit dhe Francës, Patrick Vieira, është emëruar trajner te Strasbourgu. Klubi francez njoftoi zyrtarisht për arritjen e marrëveshjes me ish-lojtarin e Francës. Vieira me Strasbourgun ka nënshkruar kontratë trevjeçare. Për 47-vjeçarin është ky një rikthim në Ligën 1. Ai nga korriku i vitit 2018 deri në dhjetor të vitit 2020 kishte udhëhequr Nicen. Vieira në dy sezonet e fundit ishte trajner i Crystal Palaces. Legjenda franceze më herët ka drejtuar edhe skuadrën nga MLS, New York City.

#### Jesusi rikthehet tek Al-Hilali

Al-Hilali mirëpret rikthimin e trajnerit Jorge Jesus. Pas një sezoni në krye të Fenerbahçes, me të cilën fitoi Kupën e Turqisë dhe e mbylli sezonin duke u renditur në vend të dytë në kampionat, trajneri portugez ka vendosur ta pranojë propozimin e klubit të Al-Hilalit. Më herët në sezonin 2018-2019 Jesus ka qenë në krye të Al-Hilalit, ndërsa tashmë rikthehet sërish në një prej klubeve arabe që është vënë shumë në lëvizje në merkaton e kësaj vere. Tashmë në ekipin e portugezit do të jetë ndër të tjerë edhe ish-lojtari i Napolit dhe Chelseat, Kalidou Koulibaly.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
N.P.L. 'PËRPARIMI' SH. A. - VUSHTRRI  
Prishtinë, më 03.07.2023  
821/23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, lidhur me pozitën e punës e cila është e paraparë me nenin 16 nën pikën 1.7.3 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. e miratuar me datë 06.05.2023 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. e duke u bazuar në vendimin me nr. 820/23 të datës 03.07.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A. me datë 03.07.2023 shpall:

### KONKURS PUBLIK

- I. Titulli:** Sigurim Fizik - roje  
**Numri i ekzekutuesve:** 1  
**Orët e punës:** 40 orë në javë  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.  
**Përgatitja profesionale:** Shkolla e Mesme apo filllore  
**Përvoja e punës:** Preferohet gjashtë (6) muaj  
**I raporton:** Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik  
**Koeficienti i pagës:** 3.9

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

#### Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A. - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

#### Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 03.07.2023 deri me datë 17.07.2023 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
N.P.L. 'PËRPARIMI' SH. A. - VUSHTRRI  
Prishtinë, më 03.07.2023  
821/23

Na osnovo članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, u vezi sa radnim mestima koja su predviđena članom 16 pododjeljkom 1.7.3 Pravilnika br. 35/23 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u N.P.L. "Përparimi" Sh.A, odobrenom dana 06.05.2023. od strane Stručnog odbora N.P.L "Përparimi" Sh.A, i na osnovu odluke br. 820/23 od godine 03.07.2023 izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh.A, dana 03.07.2023. objavljuje:

### JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Fizičko obezbeđenje  
**Broj izvršilaca:** 1  
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno  
**Trajanje imenovanja:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja  
**Stručna priprema:** Srednja škola i Osnovna škola.  
**Radno iskustvo:** Najmanje šest (6) meseci  
**Izveštava:** Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;  
**Koeficijent plate:** 3.9

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva predviđena sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, moţetetakode je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

#### Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poţeljno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;
- Prednost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

#### Uz prijavu je potrebno priloţiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL "Përparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);

#### Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Përparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastrioti Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 03.07.2023 do 17.07.2023 u 16:00 časova. N.P.L "Përparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arbnor Preniqi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "7 Shtatori" Hoteleri dhe Turizëm nga kl. 10, 11, 12, 13 Prishtinë.

Vëllaznim Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Daut Husi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Nexhat Mehollji, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPCA"

Leutrim Shehi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren

Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.